

## TERMAT E REFERENCËS

### Shpallje për (2) Jurist me eksperience në të drejtën e pronës

---

#### **INFORMATA TË PËRGJITHSHME**

Lloji i shërbimit të kërkuar: Jurist

Lokacioni: Gjakovë, Pejë, Deçan, Rahovec, Malishevë, Istog

Kohëzgjatja: 34 ditë

Periudha e punës: Dhjetor- Korrik 2025

Data e publikimit: 29.11.2024

Afati i fundit për aplikim: 13.12.2024

---

#### **1. INFORMATA PËR ORGANIZATËN**

YMCA është organizata e parë dhe njëkohësisht organizata më e madhe e rinisë në botë. U themelua në vitin 1844 në Angli për të zgjeruar më pas punën në 119 shtete të mbarë botës. Organizata jonë është anëtare në Federatën e YMCA Botës dhe YMCA Evropës dhe përfaqësuese e YMCA në Kosovë. Organizata jonë në Kosovë është partnere strategjike e YMCA në SHBA dhe YMCA Evropë duke përfshirë Mbretërinë e Bashkuar, Danimarkën, Finlandën, Francën, Gjermaninë, Norvegjinë, etj. Ndërsa në Kosovë aktualisht jemi prezent me aktivitete në njëmbëdhjetë (11) qendra në komuna të ndryshme si Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Junik, Deçan dhe Rahovec.

---

## **2. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I PROJEKTIT**

Projekti Nisma për të Drejtën e Pronës (NDP), zbatohet nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC), bashkë-zbatohet nga YMCA në Kosovo dhe financohet nga Banka Botërore/ Fondi për Paqe dhe Shtet-Ndërtim. NDP, synon të adresojë nevojën kritike për përmirësimin e qasjes në informacionin për regjistrimin e tokës dhe pronës, si dhe ofrimin e shërbimeve të këshillimit në lidhje me të drejtat pronësore për gratë, të rinjtë dhe personat e cenueshëm në Kosovë. Aktivitetet e projektit do të ndihmojnë në përmirësimin e kushteve socio-ekonomike për zhvillim të qëndrueshëm dhe paqësor, duke ndihmuar komunitetet me dokumentacionin e nevojshëm dhe të mbështetur ligjërisht për forcimin e sigurisë së të drejtave mbi tokën/pronën, duke ofruar një mundësi për pjesëmarrjen e tyre në ekonominë më të gjerë dhe duke vendosur bazat për një shoqëri më të barabartë.

Organizata YMCA in Kosovë si bashkë-zbatuese e projektit NDP, në kuadër të këtij projekti do të implementoj aktivitete të ndryshme përfshirë këtu:

- Ligjërimin/Udhëheqjen e punëtorive që do të mbahen në shkollat e mesme në 6 komuna të Kosovës në të drejtën e pronës (Gjakovë, Rahovec, Malishevë, Pejë, Deçan dhe Istog);
- Question Time- Event që po ashtu do të realizohen në të gjitha komunat e lartpërmendura, me panelist nga shoqëria civile, zyrtarë të kadastres, përfaqësues nga komunat përkatëse si dhe akter të tjerë relevant;
- Youth Camp- Kampi i cili do të realizohet në fund të projektit me të rinjë/ reja nga të gjitha komunat e lartpërmendura dhe ekspertë në fushën e pronësisë dhe punëtorë rinorë.

Për përmbushjen e këtyre objektivave YMCA in Kosovo shpallë konkurs për: Jurist me eksperience në të drejtën e pronës.

---

### 3. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSIT E EKSPERTEVE/ES

Shërbimet të cilat duhet të ofrohen nga Juristet me eksperience në të drejten e pronës për OJQ-në YMCA janë si në vijim:

- Dizajnimi i planit të punës;
  - Përgatitja e programit për punëtoritë/ Kampin
  - Përgatitja dhe përshtatja e dokumenteve në raport me projektin dhe objektivat e tij;
  - Udhëheqja e punëtorive.
  - Raportimi i detajuar i punës së realizuar i dakorduar paraprakisht me udhëheqësin e projektit;
  - Koordinim i rregullt me stafin e projektit.
- 

### 4. PERVOJA DHE KUALIFIKIMET

- Diplomë në Fakultetin Juridik
  - Minimumi 5 vite provojë pune në fushën e pronësisë/ të drejtën në pronë.
  - Trajnime të ndjekura në fushën e pronësisë/ të drejtën në pronë.
  - Eksperiencë si trajner/e apo në punë me të rinjë/ reja.
  - - Përvojë e dëshmuar në draftim ose hartim të manualeve në gjuhë miqësore për traqetin e specifikuar më lartë.
  - - Njohje e dëshmuar e praktikave dhe procedurave të aplikueshme në institucionet e Kosovës, të cilat trajtojnë çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e pronës.
  - - Përvojë e dëshmuar në analizimin dhe interpretimin e kuadrit ligjor, veçanërisht në kontekstin e pronës, trashëgimisë, procedurës civile, etj.
- 

### 5. DOKUMENTAT E KËRKUARA

- CV
  - Letër MOTIVUESE
  - DËSHMI SHITESË PËR TË MBËSHTETUR PROVOJËN
  - LETËR REFERENCE
- 

## 6 . Kohezgjatja e planifikuar

a. 18 ditë pune (Brenda periudhes 7 mujore ditët mund edhe të ndahen mes dy ekspertëve)

b. Data e paraparë e fillimit të angazhimit Dhjetor 2024

## 7. PROCEDURA E APLIKIMIT

Kandidatët e interesuar mund të dërgojnë aplikimet e juaja, përmes e-mailit: [office@ymcacosovo.com](mailto:office@ymcacosovo.com), jo më larg se me datën 13.12.2024

---

### **NOTE**

Kandidatët të cilët përmbushin kërkesat të cilat janë të paraqitura në shpallje dhe të përzgjedhur në listën e ngusht, do të njoftohen përmes email-it.

Ju lutem vini re se aplikacionet e pranuar pas afatit nuk do të konsiderohen.

Për pyetje shtesë mos hezitoni të na kontaktoni përmes emailit [office@ymcacosovo.com](mailto:office@ymcacosovo.com).

OJQ - YMCA in Kosovo ofron mundësi të barabarta të punësimit pa dallim gjinie, religjioni, nacionaliteti për të gjithë kandidatët dhe inkurajon të aplikojnë për pozitat e hapura.

---